



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT, SHËNDETIT PUBLIK**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2023

**Lënda:** Kthim Përgjigje

\_\_\_\_\_

Në përgjigje të kërkesës tuaj administruar në Bashkinë Shkodër me nr. 8118 Prot., datë 15.06.2023, ku kërkohet informacion, ju informojmë si më poshtë:

1.Sa raste janë identifikuar dhe raportuar të fëmijëve në nevojë për mbrojtje gjatë vitit 2022, si dhe gjatë muajve janar - maj 2023?

Gjatë vitit 2022 janë identifikuar dhe raportuar si në nevojë për mbrojtje 290 raste dhe gjatë tre mujorit janar – maj 2023 janë indentifikuar dhe raportuar 78 raste. Rastet e trajtuara të fëmijëve janë të ndryshme, si psh: fëmijët në situatë rruge, fëmijë të cilët nuk frekuentojnë shkollën, fëmijë me probleme shëndetësore dhe familje më probleme social-ekonomike, fëmijë të parregjistruar në gjëndjen civile, fëmijë me kushte të vështira të banimit të familjeve, të mitur në konflikt me ligjin, viktima trafikimi dhe viktima të mundshme trafikimi.

2.Për sa prej rasteve të indentifikuara si në nevojë, është miratuar Plani Individual i Mbrojtjes dhe plani është mbështetur me fond nga zëri i buxhetit të bashkisë i përcaktuar në këto plane?

Për secilin nga rastet hartohet Plani Individual i Mbrojtjes duke u bazuar në nevojat specifike që paraqet çdo fëmijë/familje. Nevojat e identifikuara mbështeten nga buxheti i planifikuar nga Bashkia Shkodër, por edhe shërbimet e tjera të ofruara nga Bashkia, institucionet e varësisë apo edhe organizata që operojnë në fushën e kujdesit shoqëror në qytetin e Shkodrës.

3.Sa është fondi i përcaktuar në buxhetin e bashkisë suaj për vitin 2023 për mbrojtjen e fëmijëve në zbatim të VKM-së nr.578, datë 03.10.2018?

Fondi i përcaktuar në buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2023, i ndarë sipas fishë projekteve më poshtë:

<b>Nr.</b>	<b>Aktivitete/Projekte</b>	<b>Totali për vitin 2023 (mijë lekë)</b>
1.	Masat për indentifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge	100
2.	Fuqizim dhe shtrirje e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve, veshmbathje (për 5 fëmijë) Pako ushqimore dhe higjenosanitare (për 5 fëmijë)	100
3.	Koordinimi i punës për parandalimin, indentifikimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik apo në nevojë për mbrojtje, Shpenzime gjyqësore/ekspert i pavarur i përcaktuar nga Gjykata, psikolog (për 5 fëmijë)	100
4.	Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, 20 Nëntori”	50
5.	Dita ndërkombetare e fëmijëve, 1 Qershori	0
6.	Shërbime alternative për fëmijët dhe familjen	100
7.	Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror	13,184.4
8.	Fuqizimi socio - ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian	100
9.	Asnjë fëmijë jashtë	271

4.Sa është fondi i shpenzuar nga buxheti vitit 2022 për trajtimin e fëmijëve në nevojë për zbatim të VKM-së nr.578, datë 03.10.2018?

Fondi i përcaktuar në buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2022, i ndarë sipas fishë projekteve më poshtë, bashkëngjitur është dhe totali i shpenzuar për vitin 2022:

<b>Nr.</b>	<b>Aktivitete/Projekte</b>	<b>Totali i parashikur për vitin 2022 (mijë lekë)</b>	<b>Totali i shpenzuar për vitin 2022 (mijë lekë)</b>
1.	Masat për indentifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge	100	98
2.	Fuqizim dhe shtrirje e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve, veshmbathje (për 5 fëmijë) Pako ushqimore dhe higjenosanitare (për 5 fëmijë)	100	0
3.	Koordinimi i punës për parandalimin, indentifikimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik apo në nevojë për mbrojtje, Shpenzime gjyqësore/ekspert i pavarur i përcaktuar nga Gjykata, psikolog	100	0

	(për 5 fëmijë)		
4.	Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, 20 Nëntori”	50	41
5.	Dita ndërkombetare e fëmijëve, 1 Qershori	0	0
6.	Shërbime alternative për fëmijët dhe familjen	100	97
7.	Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror	7,842	3,553
8.	Fuqizimi socio - ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian	200	83
9.	Asnjë fëmijë jashtë	271	220

Duke ju falenderuar,

**KRYETAR**

**Benet Beci**